

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Suedia paralajmëron: Rusia po përdor mijëra llogari të rreme për të ndikuar zgjedhjet në Europë, në shë njëstër Gjermania dhe Franca!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/suedia-paralajmëron-rusia-po-perdor-mijera-llogari-te-rr-eme-per-te-ndikuar--i585456
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 15:47:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 17:00:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	288a9d60a00ffd18790faabf6314d854c60499c615add69dc3f23112b82a1311
TEKSTI	15e198f97ec3f17861d6232a30d223ca5096403f1e11bf0c8f863b1eeb024687
PAMJA	151ee3fcb5291ae2b3d376f79a69d00505ad6ec91981e20a968bcd630c04482

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7e277d539eaf0ebf2ba6cc9a7cfae7abd9988728fca52be9b862b446d4ec41dc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7e277d539eaf0ebf2ba6cc9a7cfae7abd9988728fca52be9b862b446d4ec41dc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1 e [A ka OSBE/ODIHR në Amerikë? Banesat pa pronar - Avokati: Ne emër të kujt bëhet legalizimi? / Hiqen pengesat e gjykatave / DEBAIL / Frederik Ndoci: Ja pse diktatura nxori artistë dhe prodhoi fil](#)
fundit

Suedia paralajmëron: Rusia po përdor mijëra llogari të rreme për të ndikuar zgjedhjet në Europë, në shënjestër Gjermania dhe Franca!

11 Shtator 2026, 19:00 Bota TEMA



Suedia paralajmëron: Rusia po përdor mijëra llogari të rreme

Rusia përbën një kërcënim për zgjedhjet e ardhshme në disa prej demokracive më të rëndësishme europiane dhe rrjetet sociale duhet të bëjnë më shumë për të ndaluar rrjetet e botëve që përhapin dezinformim. Paralajmërimi vjen nga Magnus Hjort, drejtori i Agjencisë Suedeze për Mbrojtjen Psikologjike.

Në një intervistë për Politico, Hjort tha se Kremli i sheh zgjedhjet si një mundësi për të nxitur përçarje dhe polarizim në shoqëritë europiane. Sipas tij, një nga objektivat kryesorë është krijimi i dyshimeve te votuesit për vazhdimin e ndihmës financiare dhe ushtarake ndaj Ukrainës, përmes përhapjes së pretendimeve të rreme për korrupsion dhe abuzime.

Sipas vlerësimit të autoriteteve suedeze, Moska nuk është e fokusuar te zgjedhjet parlamentare që do të mbahen këtë fundjavë në Suedi, pasi në vend ekziston një konsensus i gjerë politik për mbështetjen ndaj Ukrainës.

Në vend të kësaj, vëmendja e Rusisë është përqendruar te Gjermania dhe Franca, ku pritet të zhvillohen procese të rëndësishme zgjedhore. Hjort tha se Gjermania, me zgjedhjet rajonale dhe lokale, si edhe Franca, me zgjedhjet presidenciale të vitit të ardhshëm, konsiderohen objektiva me ndikim më të madh.

Ai kujtoi se në Gjermani tashmë ka pasur shqetësime për përpjekje të ndërhyrjes ruse, përfshirë publikimin e materialeve të rreme në rrjetet sociale, ku kandidatë janë akuzuar në mënyrë të rreme për korrupsion dhe krime seksuale. Sipas tij, në Francë situata ndiqet gjithashtu me vëmendje, ndërsa Marine Le Pen kryeson në sondazhet para zgjedhjeve presidenciale.

Hjort kritikoi platformat si Meta, TikTok dhe X, duke thënë se nuk po bëjnë mjaftueshëm për të çmontuar rrjetet e automatizuara të botëve që shpërndajnë dezinformim të huaj.

Ai tha se agjencia që drejton regjistrin vazhdimisht fushata të manipulimit të informacionit nga Rusia, Kina dhe Irani. Së fundmi, sipas tij, është identifikuar edhe një operacion rus që përdor metodën e njohur si "Matrojshka", e cila synon të angazhojë gazetarët dhe verifikuesit e fakteve me materiale të rreme, duke u konsumuar kohën dhe burimet.

Një tjetër rast i evidentuar nga autoritetet suedeze është një rrjet prej rreth 1.200 botësh në platformën X, që dyshohet se kontrollohej nga një aktor shtetëror. Fillimisht këto llogari publikonin përbajtje të padëmshme për pushimet apo sportin, ndërsa më pas u përdorën për të shpërndarë mesazhe polarizuese mbi çështje politike. Sipas Hjort, vetëm gjatë viteve 2025 dhe 2026 ky rrjet publikoi rreth 50 mijë postime dhe komente.

Megjithatë, ai theksoi se autoritetet suedeze nuk shohin aktualisht një fushatë të koordinuar kundër zgjedhjeve të kësaj fundjave në Suedi. Sipas tij, një nga rreziqet më të mëdha është që frika nga ndërhyrjet e huaja të përdoret më pas për të vënë në dyshim legjitimitetin e procesit zgjedhor.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Pse nuk po funksionon diplomacia e Jared Kushnerit dhe Steve Witkoffit dhe pse Marco Rubio po qëndron larg tyre?](#)

17:10 Bota

[Bota kërcënohet nga terrorizmi/ Kreu i Inteligjencës britanike: Goditje si 11 shtatori](#)

16:50 Bota

[Huthit marrin kontrollin e pikave strategjike në Detin e Kuq, alarm për tregtinë globale](#)

16:00 Bota

[Merz i cilësoi politikat e tyre ndaj emigrantëve si "spastrim etnik," AFD kallëzim penal kundër Kancelarit](#)

15:30 Bota / 1 koment

[Tensionet në rajon, diskutime mes Arabisë Saudite dhe Iranit](#)

15:20 Bota

[11 shtatori i përgjakshëm i Kilit: si erdhi Pinocheti në pushtet dhe kush e vrau Allenden?](#)

14:50 Bota / 3 komente

[Rriten tensionet për Ishujt Falkland, presidenti i Argjentinës anulon vizitën në Mbretërinë e Bashkuar!](#)

14:10 Bota / 2 komente

[Sulm kibernetik në Berlin - "Masakër" të dhënash, 1.4 milionë përfundojnë në 'Darknet'](#)

13:40 Bota

[Republikanët mbyllin Konventën, Vance kandidat në 2028-ën?](#)

12:10 Bota / 6 komente

[Zelensky konfirmon takimin me Trump në fund të shtatorit: Pas mbledhjes në Nju Jork mund të jem më i hapur për negociatat](#)

10:05 Bota

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...](#)

09:45 Politika / 22 komente

[Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...](#)

15:45 Politika / 30 komente

[EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej “afërën e armëve” m...](#)

15:30 Dossier / 13 komente

[Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...](#)

13:04 Politika / 51 komente

[‘Kallëzim se po zbatoj ligjin’, ministri Malaj publikon p...](#)

19:05 Politika / 77 komente

Blog Tema

[A ka OSBE/ODIHR në Amerikë?](#)

17:40 Blog

[Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare](#)

17:00 Blog

[Shteti i Ieshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve](#)

13:50 Blog / 13 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">• Politika• Kronika• Editorial• Blog• Bota• Sport• Shëndeti• Turizëm | <ul style="list-style-type: none">• Sociale• Ekonomia• Antena• Rajoni• Kulturë• Lifestyle• Dossier• Hi-Tech |
| <ul style="list-style-type: none">• Kontakt• Te dhënat personale• Cookies | |

Built and Monetized by